



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 21.07.2021, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-506

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajraliu, Mirlinda Sadiku, Eman Rrahmani, Fadil Nura, Enver Haliti, Yllza Hoti, Albana Bytyçi dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Bekim Arifi dhe Jasmina Dedic.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Të ftuar: Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike z.Xhelal Sveçla dhe kryesuesi i Bordit dhe Kryeshefi Ekzekutiv i K.R.U.”Hidroregjioni jugor” Sh. A. Prizren.

Pjesëmarrësit tjerë: Arvita Zyferi, Florim Beqiri, Mehmet Muçaj, Saranda Hysaj –Bajraliu, dhe Enver Buqolli nga ZKA. Jeta Tela dhe Vlora Gojani nga MPB. Zenel Zenelaj, Ibrahim Bajraktari dhe Ymridin Sylejmani nga KRU Hidroregjioni Jugor Prizeren.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.6.2021 dhe 22.6.2021;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020.
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të K.R.U.”Hidroregjioni jugor” Sh. A. Prizren për vitin 2020;
5. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit, e cila pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8.6.2021 dhe 22.6.2021;

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 8.6.2021 dhe 22.6.2021 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020.

Kryesuesja, tha se ZKA ka audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020, të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Për më tepër fjalën ja kaloi deputetes raportuese Mirlinda Sadiku.

Mirlinda Sadiku tha se vlen të theksohet Raporti i auditimit për MPB është bërë në pasqyrat financiare për vitin 2019 dhe atë për MPB dhe MAP ku gjithsej janë dhënë: 27 rekomandime dhe atë 14 rekomandime për MPB dhe 13 MAP deri në fund të vitit auditues për vitin 2020 janë 15 rekomandime të zbatuara, 2 rekomandime ishin pjesërisht të zbatuara, 4 rekomandime nuk janë filluar porse 6 rekomandime ishin të mbyllura të pazbatuara (nuk aplikohen me). Kurse në vitin 2020 janë dhënë gjithsej 16 rekomandime kurse opinioni i Auditorit për këtë vit është Opinion i kualifikuar. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik,

Të gjeturat janë kryesisht tek: planifikimi jo i drejte i buxhetit, detyrimet kontingjente raportimi i tyre, fusha e prokurimit, regjistri i projekteve kapitale, mos vijimi në punë i komunitetit jo shumicë, tejkalim kontratash etj,

E gjetur e Auditorit është Kompensim i parregullt i stafit të AME-së për punë jashtë orarit, ndërrimeve të natës Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) nga buxheti i ndarë (179,424€) për shtesa për zjarrfikës nga kategoria paga dhe mëditje kishte bërë kompensimin e të gjithë stafit në mënyrë proporcionale përfshirë edhe stafin që nuk janë zjarrfikës. Vlera e paguar për stafin që nuk janë zjarrfikës ishte 107,856€ e që do të thotë shfrytëzim jo racional i buxhetit.

Po ashtu vlen të theksohet se edhe prezantimi i detyrimeve kontingjente nuk është i sakte Detyrimet kontingjente (6,918,708€) të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2020, nuk ishin të sakta për shkak se vlera financiare 789,179€, e shpalosur si detyrim kontingjent, nuk ishte e mbështetur me dëshmi. Më tutje, një padi e cila ishte bërë në vlerë 100€, në listën e detyrimeve kontingjente dhe PFV ishte raportuar në vlerë 100,000€ dhe në rastin tjetër padia në vlerë 37,967€, në listën e detyrimeve kontingjente dhe PFV ishte raportuar në vlerë 379,678€.

E gjetur tjetër është regjistri jo i plotë i investimeve kapitale Vlera e pasurisë (112,904,929€) e prezantuar në nenin 19.3.1 pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se: Projekti për zgjerimin e ngrohjes në shumë 114,503€ në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ishte regjistruar dy herë në regjistrin e pasurisë. Po ashtu, ndërtesat e AKSP-së (konvikti për meshkuj, konvikti për femra, salla e sportit, objekti i ngrohjes) nuk janë të raportuara si pasuri në regjistrin e pasurisë edhe pse ato objekte janë duke u përdorur nga AKSP.

Më tutje, në Policinë e Kosovës kemi identifikuar që në regjistrin e pasurisë nuk ishte i regjistruar agregati ftohës- chiller me kapacitet $Q_{ft}=195W$ deri 200,4KW komplet me pompë, amortizator të gypave me të gjitha pajisjet përcjellëse. Kjo pasuri edhe pse ishte pranuar nga komisioni me datën 08.07.2020 nuk ishte e regjistruar në regjistrin e pasurisë mbi 1,000€. Vlera financiare e pasurisë ishte 35,462€. Projekti “Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it” me vlerë 1,681,074€ (kontrata bazë 1,643,051€ e lidhur në vitin 2016 dhe aneks kontrata 38,022€ e lidhur në vitin 2017) ishte pranuar nga Komisioni i pranimit teknik me datë 13.03.2020. Në regjistrin e pasurisë ky projekt ende mbahej i regjistruar si investim në vijim në vlerë 1,662,938€ dhe jo si pasuri në përdorim. Si rrjedhojë e kësaj Ministria ende nuk kishte filluar të aplikoj zhvlerësimin edhe pse objekti ishte funksional dhe në përdorim. Projekti “Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës faza III” me vlerë të kontratës 7,297,021€ kishte përfunduar me 10.12.2020 duke u bazuar në raportin e inspektimit final të kryer nga Komisioni i inspektimit i cili e cilëson objektin në funksion të plotë. Objekti ende nuk i kishte kaluar rregullat dhe procedurat e dorëzimit tek OB që është përfituese e projektit (Universiteti i Mitrovicës) dhe si rrjedhojë mbahet në regjistrin e pasurisë së MPB-së si investim në vijim. Ne kemi testuar pagesën në vlerë 689,581€.

Vlera e pasurisë (3,743,869€) e prezantuar në nenin 19.3.2 për pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€ nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se: • Në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) kemi identifikuar që në regjistrin e pasurive nuk ishin regjistruar 26 kompjuterë në vlerë 11,804€; • Në MPB kemi vërejtur që 150 shtretër metalë në vlerë 17,250€ dhe 150 dyshekë ortopedikë në vlerë 7,500€, figurojnë të regjistruar më shumë se një herë në regjistrin e pasurisë nën 1,000€. Si rrjedhojë vlera neto e shtretërve metalikë ishte mbivlerësuar për 41,560€ ndërsa vlera neto e dyshekëve ortopedikë ishte mbivlerësuar për 18,108€. • Në AKSP kemi identifikuar se pasurisë nën 1,000€ të blerë në vitin 2020 nuk i është llogaritur zhvlerësimi sipas kërkesave të rregullores së pasurive dhe si rrjedhojë, pasuritë ishin mbivlerësuar për 588€. Më tutje kemi vërejtur se në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ janë të regjistruara pasuritë nga dy herë (3 raste).

- Kompensim i parregullt për Sekretarinë e Bordit të AKSP-së por vlen të theksohet se me datë 03.12.2020 AKSP e ka shfuqizuar atë vendim për kompensim, poashtu është identifikuar që menaxherët të kontratave ishin caktuar të njëjtit zyrtarë që kishin qenë edhe në komisionin e vlerësimit të ofertave. Kjo dukuri nuk është në pajtim me kërkesat e UOPP. Këto dobësi i kemi identifikuar në këto projekte: • "Furnizim me Aparatë të Frymëmarrjes dhe bombola të ajrit" në (AME) në vlerë prej 559,202€; • "Furnizim Emergjent me Dezinfektues për duar" në (PK) në vlerë prej 15,600€; dhe • “Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes, ftohjes, klimatizimit dhe të makinave të lavandarisë” në (AKSP) në vlerë prej 24,888€. Emërimi i menaxherit të projektit jo në pajtim me kërkesat ligjore por poashtu ka gjetje edhe në aspektin e prokurimit. Në procedurën e negociuar të prokurimit "Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Pastrimit në AKSP" kemi vërejtur se AKSP me 13.01.2020 kishte lidhur kontratë publike kornizë duke mos e përcaktuar afatin kohor të kontratës. Po ashtu, kemi vërejtur se në dosjen e tenderit vlera e

parashikuar e kontratës publike kornizë ishte 50,000€ ndërsa kontrata ishte lidhur në vlerë 14,455€ për shërbime mujore. Më tutje, AKSP nuk kishte caktuar menaxher të kontratës si dhe nuk kishte përgatit plan të menaxhimit të kontratës. Deri në fund të vitit 2020 me këtë kontratë ishin paguar 159,005€, shërbime për mirëmbajtje dhe pastrim.

Sipas vendimit nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunitat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore. Ish MAP ka qenë e obliguar t’i sistemoj 20 punëtorë të komunitetit serb. Zyrtarët e lartcekur, në vitin 2020, nuk ishin paraqitur në vendin e punës, përderisa ministria kishte bërë pagesën e pagave të tyre në vlerë totale 100,583€. Shkaku i mos paraqitjes në punë të këtyre zyrtarëve ishte mos krijimi i kushteve të duhura për punë.

Tejkalimi i vlerës së kontratës është identifikuar se AKSP gjatë periudhës 2019-2020 kishte bërë pagesa në vlerë 660,328€, duke bërë tejkalimin e vlerës së kontratës për 392,016€, mbi normën e lejuar 30%. Vlera totale indikative e kontratës 206,394€, plus 30% (61,919€), gjithsej shuma e lejuar për pagesë 268,312€. E gjetur tjetër është Pagesa e bërë pas përfundimit të afatit të kontratë gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar që me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm ishin bërë dy pagesa në vlerë prej 50,042€ për Telekomin e Kosovës për shkak se kishte skaduar kontrata.

Nga testimi i 12 mostrave për furnizim me ushqim dhe pije në vlerë prej 296,328€, kemi vërejtur se AKSP me vendim të datës 31.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, kishte paguar 39,454€, shujta për ushqim për stafin e saj, përkundër faktit që këto pagesa nuk janë të lejuara sipas Ligjit për Ndarje Buxhetore nga kategoria mallra dhe shërbime. Ndikimi Pagesat e tilla jo në pajtim me ligjin nga kategoria mallra dhe shërbim.

Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara një numër i stafit policor ende është sistemuar në pozita të punës pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Sipas të dhënave nga njësia e personelit, 168 zyrtarë policor vazhdojnë të mbeten të sistemuar në pozita ku kërkohet gradë më e lartë se sa grada që aktualisht e kishin arritur të punësuarit përmes procesit të rregullt të gradimit. Mos-realizim i projektit brenda afatit kohor Ministria e Administratës Publike (MAP) me datë 24.09.2019 kishte lidhur kontratë me OE për “Studimin e fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës” në vlerë prej 650,000€ me kohëzgjatje gjashtë mujore. Në kontratë ishin paraparë dy pozicione:” Kryerja e fizibilitetit të Spitalit të Prishtinës” dhe “Hartimi i projektit detal (zbatues)”. Ne kemi identifikuar se projekti nuk kishte arritur të realizohet brenda afatit të paraparë me kontratë. Në mars të vitit 2020 OE kishte dorëzuar në Ministri, Draft Studimin e Fisibilitetit për komente, por nuk kishte pranuar përgjigje nga palët e interesit të përfshira në këtë projekt (MAP, Ministri i Shëndetësisë (MSH) dhe Komuna e Prishtinës). - Regjistrim dhe raportim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në lidhje me gjobat e trafikut, Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 22,602,765€. Rritja ishte bërë me rishikim të buxhetit në shumë 5,796,850€ si dhe me vendime të qeverisë për ndarje dhe kursime, buxheti ishte rritur për 16,805,915€. Ky ndryshim i buxhetit final krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë paga dhe mëditje ishte si rezultat i planifikimit jo të mirë të buxhetit.

Po ashtu deputetja raportuese propozojë këtë: REKOMANDIM: Rekomandojë MPB që të adresohet çështja e punëtorëve të komunitetit Serb dhe neve si komision brenda një periudhe

prej 3 muajve të na kthehet një raport përfundimtar se çfarë është ndërmarr në lidhje me këtë çështje.

Kryesuesja tha se pjesa me e madhe e të gjeturave ka të bëjë me Akademinë Policore dhe me Shërbimin Policor të Kosovës. Mungesa e regjistrimit të sakët të pasurisë, pagesat nga kodet ekonomike të gabuara, obligimet e papaguara në rritje, pagesa e shtesave për komplet stafin për programin e gatishmërisë emergjente etj. Një e dhënë që tregon se brenda këtij Institucioni ka patur parregullsi, Ne si komision do të presim planin e veprimit se si mendon MPB ti adresojë këto të gjetura.

Ministri MPB tha se janë pajtuar me të gjeturat e auditorit, po ashtu tha se është duke u punuar në përgatitjen e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve. Po ashtu u përgjigj në pyetjet e parashtruara nga deputetët. Ministri dha sqarimet për të gjitha rekomandimet e dhëna në raport.

Kryesuesja shtoi se gradimet në polici gjithëherë kanë paraqitur telashe në mungesë të buxhetit në fund të vitit, përkundër faktit se në fillim vitit buxheti ndahet sipas gradave aktuale. Pyeti se a është rregulluar kjo çështje me rishikim të buxhetit? Si dhe pyeti se si mendoni të rregullohet regjistrimi i aseteve në sistemin E-Pasuria?

Arta Bajraliu pyeti se a janë marrë masa ndaj zyrtarëve brenda institucionit të MPB për shkeljet e konstatuar nga Auditori i jashtëm të dhëna në raport?

Ministri MPB u përgjigj në pyetjet e deputetëve.

Fadil Nura, tha se në bazë të të gjeturave të raportit të auditimit del se një përgjegjësi keni ju si Ministër sepse gjatë vitit 2020 keni qenë zv Ministër dhe ud. Ministër në MPB. Po ashtu pyeti se cili nga rekomandimet e dhëna në raport është zbatuar deri tani, si dhe pyeti se a ndiheni përgjegjës për këto rekomandime të cilat përfshijnë periudhën kohore sa ju ishin në pozitë Ministre në MPB? Po ashtu pyeti e a janë duke u paguar 20 të punësuar minoritar serb sipas marrëveshjes së Brukselit? A është duke u bërë pagesat e policëve për punët jashtë orarit.etj.

Ministri MPB u përgjigj në pyetjet e deputetëve.

Arvita Zyferi, tha se për planifikim të buxhetit ZKA nuk ka dhënë rekomandime, jo vetëm për këtë rast por edhe për raste të tjera.

Hajdar Beqa, pyeti se sa është shuma e mjeteve të paguara për vitin e kaluar për 20 të punësuar të komunitetit serb të cilën janë paguar pa u lajmërua asnjëherë në punë, cilat veprime keni ndërmarrë ju si Ministër? Të gjitha të gjeturat nga 16 gjithsejtë nga ky raport ishin të nivelit të ulët të menaxhimit, cila është përgjegjësia juaj në këtë? Pyeti se tek furnizimi emergjent dhe tek mbikëqyrja e kontratave a jeni në dijeni për veprimet e ndërmarra nga zyrtarët përgjegjës për menaxhim të kontratave, ku janë ngecjet dhe dështimet në këtë proces? A ka Ministria plan konkret për adresimin të këtyre të gjeturave?

Ministri MPB u përgjigj në pyetjet e deputetëve.

Enver Haliti tha se me rastin e shqyrtimit të RVA 2019, Komisioni ka dhënë rekomandim që të mos lejohet buxhet dhe të mos lejohet numër i të punësuarëve për vitin 2021, për të ashtëquajturën mbrojtje civile pa u siguruar që janë plotësuar kushtet për të punuarit dhe pa u siguruar se janë duke respektuar orarin e punës. Me këtë Komisioni ka bërë një punë të mirë megjithatë shtyrohet pyetja cili është kontributi i Institucioneve tjera në këtë drejtim? Ndersa tek MPB sipas Ministrit Sveqla është duke u analizuar mënyra dhe forma se si të ju sigurohen

kushtet dhe nëse konstatohet se ka shkelje ndaj atyre të cilët nuk kanë respektuar rregullat do të shqiptohen edhe masa ndëshkimore.

Albana Bytyqi, pyeti se kush është përgjegjës për urdhërin e dhënë të Policisë për arrestimin e përfaqësuesve dhe simpatizantëve të PSD-së?

Ministri MPB tha për këtë mund ta pyetni Drejtorinë e Policisë, janë përgjegjësit e ndara.

Kryesuesja pyeti se a është në procedurë Ligji për Zyrtarët Publik për fakin se zgjedhjet lokale po afrohen dhe është në interes të dihet për disa nene të cilat janë problematike?

Ministri MPB tha se ka ngecje në reformën e administratës publike dhe nuk dihet sakët se kur ky Ligj do të vijë në Kuvend për ndryshim dhe plotësim.

Kryesuesja pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar ftojë komisionin për të vendosur se si të veprhet me raportin.

Përfundim

KMFP vendosi që, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020, të mos adresohet për në Seance Plenare, ndërsa rekomadimi i propozuar nga deputetja raportuese i dergohet vetëm Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të K.R.U."Hidroregjioni jugor" Sh. A. Prizren për vitin 2020

Kryesuesja, në vijim të këtij dokumenti, gjeni një përmbledhje të shkurtër lidhur me çështjet më të rëndësishme të dala nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a për vitin e përfunduar me 31.12.2020. Ky raport ka të bëjë me auditimin e PFV-ve në aspektin financiar dhe të pajtueshmërisë, i cili është i obligueshëm me ligj, dhe përmbledhë çështjet të cilat kanë rezultuar nga auditimi i PFV-ve. Qëllimi i auditimit ishte dhënia e opinionit për pasqyra financiare dhe konkluzionin për pajtueshmëri, nëse PFV janë përgatitur dhe prezantojnë një pamje të drejte dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Auditimi i PFV të Kompanisë për vitin e përfunduar me 31.12.2020, përfshinë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Auditimi i këtyre pasqyrave financiare është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik. Opinioni i auditimit, opinioni i auditimit për PFV-të e Kompanisë për vitin 2020 është Opinion i Kualifikuar. Më pas fjalën ja kalojë deputetit raportues.

Enver Haliti tha se Auditori ka krijuar bazën për Opinion të Kualifikuar, për arsyen si në vijim: Hidroregjioni kishte angazhuar një kompani të licencuar për rivlerësimin e pasurive dhe më datë 31 maj 2020 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij është Opinioni i auditimit, Opinioni i auditimit për PFV-të e Kompanisë për vitin 2020 është Opinion i Kualifikuar. Auditori ka krijuar bazën për Opinion të Kualifikuar, për arsyen si në vijim: Hidroregjioni kishte angazhuar një kompani të licencuar për rivlerësimin e pasurive dhe më datë 31 maj 2020 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti dhe bazuar në llogaritjet auditorëve nga analizimi dhe krahasimi i tij me regjistrin e pasurive, vlerat e prezantuara në PFV të pasurive, shpenzimet e zhvlerësimit dhe rezerva e rivlerësimit janë të nënvlerësuara. Rrjedhimisht, edhe shpalosjet për zërin e pasurive dhe rezervave nuk prezantojnë gjendjen e saktë.

Konkluzioni për pajtueshmëri, Të hyrat nga subvencionet dhe të hyrat nga grantet ishin të nënvlerësuara për 50,679€, për shkak se kompania kishte aplikuar TVSh-në, edhe përkundër faktit që subvencionet dhe grantet ishin të liruara nga TVSH, sipas ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave. Prezantim jo i saktë i pasurive në pasqyrën e pozitës financiare, Hidroregjioni kishte angazhuar një kompani vlerësuese për rivlerësimin e pasurive dhe më datë 31 maj 2020 kishte pranuar raportin përfundimtar të rivlerësimit. Bazuar në përmbajtjen e këtij raporti dhe bazuar në llogaritjet tona nga analizimi dhe krahasimi i tij me regjistrin e pasurive dhe vlerat e prezantuara në PFV, janë identifikuar çështjet si në vijim: Pasuritë pas rivlerësimit nuk ishin trajtuar sipas kërkesës së SNK 16. Si rrjedhojë e kësaj, vlera neto e pasurive afatgjata me 31 dhjetor 2020 ishte nënvlerësuar për 504,057€ (në PFV ishte paraqitur vlera 26,777,286€, ndërsa sipas auditimit do të duhej të ishte 27,281,343€); Rezerva e rivlerësimit në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet me 31 dhjetor 2020 ishte 5,317,365€ (si rezultat i rivlerësimit të pasurive), ndërsa sipas përlllogaritjeve të auditorit kjo vlerë do të duhej të ishte 6,053,202€ duke i nënvlerësuar për 735,837€. Gjithashtu, rezervat tjera në vlerë prej 14,574,432€ janë rezultat i rivlerësimit të vitit 2007. Kjo për shkak se, kompania zhvlerësimin e përlllogaritur pas rivlerësimit të vitit 2007 e kishte njohur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave pa zvogëluar rezervën e rivlerësimit bazuar në jetën e mbetur të përdorimit. Megjithatë, pjesa e mbivlerës është dashur të amortizohet veçmas dhe të zvogëlonte gradualisht rezervën përgjatë viteve të mbetura të përdorimit. Shpenzimet e zhvlerësimit të prezantuara në PFV nuk i kishte përlllogaritur duke u bazuar në jetëgjatësinë para rivlerësimit pra në vlerën historike të pasurive për periudhën para rivlerësimit, por duke marrë për bazë jetëgjatësinë sipas raportit të rivlerësimit dhe duke e kalkuluar për tërë vitin. Gjithashtu, për shpenzimet e zhvlerësimit për pjesën e pasurive të rivlerësuara është aplikuar jetëgjatësia pas rivlerësimit duke e zbritur rezervën në fund të vitit. Kalkulimet ishin bërë duke supozuar se rivlerësimi jep vlerën e pasurive me datë 01 janar 2020 dhe si rrjedhojë shpenzimet e zhvlerësimit janë nënvlerësuar për 231,781€ (sipas PFV-ve 809,336€ dhe sipas kalkulimeve të auditorit 1,041,117€). Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen). Nënvlerësimi i të hyrave nga grantet dhe subvencionet. Në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, në kuadër të zërit. Të ardhurat tjera në vlerë 1,134,739€, ndër të tjera janë prezantuar edhe zërat "Të hyrat e shtyra nga grantet" në vlerë 280,883€ dhe "Të hyrat nga subvencionet" në vlerë 370,370€. Të hyrat nga grantet, ishin prezantuar në vlerë 280,883€, shumë kjo e nënvlerësuar për 21,049€. Të hyrat nga subvencionet janë pranuar në pjesën e parë të vitit 2020 në vlerë 400,000€, mirëpo kompania nuk kishte njohur subvencionet aq sa i kishte pranuar, por kishte prezantuar vlerën 370,370€, shumë kjo e nënvlerësuar për 29,630€. Këto dy lloje të të hyrave bashkërisht janë të nënvlerësuara për 50,679€. Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen). Mos barazimi i evidencave kontabël dhe letër konfirmimeve për të pagueshmet Llogaritë e pagueshme tregtare të prezantuara në Pasqyrën pozicionit financiar, nuk prezantojnë saktë gjendjen e tyre. Për të testuar saktësinë e llogarive të pagueshme tregtare, përveç procedurave tjera, auditorët kanë dërguar 30 letër konfirmime tek palët e treta/furnitorët me vlerë të përbashkët prej 2,448,649€. Deri në përfundim të auditimit kanë pranuar 20 letër konfirmime me vlerë të përbashkët prej 1,829,232€. Bazuar në analizat e auditorëve dhe letër konfirmimet e pranuar nga furnitorët, në (17) raste ekzistojnë mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe shënimeve të furnitorëve. Në (12) raste shuma e detyrimit ishte mbivlerësuar për 78,958€, ndërsa në pesë (5) të tjera detyrimi ishte nënvlerësuar për 17,959€. Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen). Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të kompanisë kishte rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, katër (4) ishin në proces dhe një (1) rekomandim nuk është adresuar ende. Vlen të theksohet se nder vite kjo kompani nuk kishte opinione të mira të

auditimit si ne vijim. 2019 Opinion i kundërt, 2018 Opinion i kundërt, 2017 Opinion i kualifikuar.

Perfaqësuesi i KRU Hidroregjioni Jugor Prizeren. Përmedi veshtërsitë që ka kjo kompani në përmbushjen e obligimeve si ndaj ATK-së, KOSST dhe sigurimin e pagave të të punësuarëve në këtë Kompani. Sipas tijë tani ATK-së ia kanë kryer obligimet ndërsa për KOSST kanë programuar borxhin me një marrëveshje.

Kryesuesja tha se sipas diskutimeve del se kompania ka problem me borxhet e vjetra të trashëguara dhe me humbjet komerciale të ujit.

Eman Rrahmani pyeti se që sa kohë ZKF dhe Kreshefi është në këtë pozitë? Ngriti shqetësimin për pagesëne borgjit ndajë Kompanisë përmes permbarueseve, dhe pyeti pse konsumatorët po e kontestojnë borgjin e krijuaj, a keni ngarkuar ju me fatura konsumatorët etj. Gjykata e një borxhion me te vjeter se një vit vetem se duhet ta deshmoni atë. A jeni pajtuar me te gjeturat e Auditorit? Sa është numri i të punësuarëve ne kete Kompani, dhe se a keni plotësuar numrin e te punësuarëve me persona me nevoja të veçanta? Po ashtu pyeti se sa është shuma e mjeteve që harxhojnë objektet e kultit dhe se a kanë njehsorë të vendosur? Po ashtu pyeti se sa është e sigurt cilësia e ujit? Dhe Pyeti ZKA-ne sa i perketë letermenaxhmentin a është dorezuar ne Komision?

Perfaqësuesi i KRU Hidroregjioni Jugor Prizeren u përgjigj në pyetjet e deputetëve.

Enver Haliti tha se nuk ka nevojë të dërgohet për në seance plenare, sepse gabimet ne pasqyra janë të natyrës së kontabilitetit dhe nuk bëhet fjalë për ndonjë shkelje materiale. Perkunder faktit se opinioni nuk është i mire. Rekomandimi ti dërgohet vetëm Ministrisë së Ekonomisë që sa me shpejtë të zgjedh Bordin, dhe që kjo kompani të jete në shërbim të atij regjioni.

Kryesuesja tha se problemet te kjo kompani është në humbjet komerciale dhe në borxhet e papaguara te bartuara nga vitete paraprake.

Përfundim

KMFP vendosi që, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh. A. Prizren për vitin 2020, të mos adresohet për në Seance Plenare, ndërsa rekomandimi i propozuar nga deputeti raportues ti dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, për caktimin e Bordit të ri në këtë Kompani.

5. Të ndryshme.

Kryesuesja, tha se për mbledhjen e radhës së Komisionit do të shqyrtohet raporti i auditimit të performancës transparenca dhe llogaridhënja në procesin e financimit të OJQ-ve. Deputete raportuese Hykmete Bajrami.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,
Kryetare e Komisionit
